

Terma Reference

Thirrje për ekspert për hartimin e protokollit të punës për ofrimin e shërbimeve sociale mbështetëse për fëmijët dhe familjet në Bashkinë Durrës

Konsulencë	Thirrje për ekspert për hartimin e protokollit të punës për ofrimin e shërbimeve sociale mbështetëse për fëmijët dhe familjet në Bashkinë Durrës.
Kohezgjatja e shërbimit	Qershor 2025 - Shtator 2025
Zona e projektit	Bashkia Durrës
Data e mundshme e fillimit të shërbimit	6 Qershor 2025

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një ekspert/e, për të hartuar protokollin e punës për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen në Bashkinë Durrës, në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe ëorld Vision Albania.

Kjo ekspertizë do të ofrohet në mbështetje të Bashkisë Durrës, Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, në kuadër të ngritjes dhe zhvillimit të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen. Protokollin duhet të jetë një dokument që ti shërbejë profesionistëve, pjesë të ekipit të Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dhe ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Protokollin e punës duhet të bazohet në modelin e SHMFF, model i miratuar nga Komiteti Drejtues për çështjet e deinstitutionalizimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Fokusi i punës së SHMFF janë familjet me nivel shumë të lartë vulnerabiliteti, ribashkimi i fëmijëve me familjet biologjike, parandalimi i ndarjes së fëmijës nga familja si dhe kujdesi alternativ me bazë familjen.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjtet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qëndror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti po zbatohet në Bashkinë Durrës “Forcimi i krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për të mbrojtur fëmijët dhe komunitetet vulnerabël në Bashkinë e Korçës dhe Durrësit” në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe ëorld Vision Albania. Metodologjia e propozuar bazohet në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC), standardeve ndërkombëtare të kujdesit alternativ për fëmijët dhe prioritetet kombëtare, duke përfshirë programin e Qeverisë së Shqipërisë, i cili synon të avancojë një sistem të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm për të mbështetur individët gjatë

gjithë ciklit të jetës. Ajo përdor një model socio-ekologjik që vendos fëmijën në qendër të të gjitha ndërhyrjeve, i rrethuar nga katër shtresa kryesore: kujdestarët/familja, komuniteti, kultura dhe shoqëria, si dhe mjedisi më i gjerë/politikat.

Në Bashkinë Durrës, projekti synon krijimin e një strukture të qëndrueshme për shërbimet mbështetëse për fëmijët dhe familjet, duke integruar ekipe në mbështetjen e familjes, kujdesin alternativ dhe shërbimet komunitare. Fokusi është në bashkëpunimin me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, NJVNR dhe aktorët lokalë për identifikimin e hershëm të rasteve dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja. Kapacitetet e stafit të institucioneve dhe qendrave komunitare do të fuqizohen përmes trajnimeve dhe mbështetjes afatgjatë në punë. Programi përfshin mbështetje për familjet në rrezik, duke siguruar shërbime multidisiplinore si ndihma psikologjike, shërbime të specializuara, klasa prindërore, mbështetje për aksesin në shërbime, etj.

Objektivat e Angazhimit

Nën mbështetjen dhe bashkëpunimin me ekipin koordinues të programit, ***Ekspteri/ekspertja, do të angazhohet për:***

- Hartimin e një dokumenti-protokolli pune për profesionsitët që ofrojnë shërbime pranë SHMFF
- Protokolli duhet të përmbajë
 - Llojet e shërbimeve që do të ofrohen dhe standardet ku bazohen
 - Kategorinë e përfituesve të shërbimeve
 - Procedurat e përfitimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror
 - Metodologjinë e ofrimit të shërbimeve, përfshirë dhe shërbimet e specializuara
 - Roli dhe përgjegjësitë e strukturës dhe profesionstëve që duhet të ofrojnë këto shërbime
 - Dokumentimi i procesit të ofrimit të shërbimeve
 - Politikat e mbrojtjes së përfituesit të rritur/fëmijë
 - Instrumentat e punës
 - Mekanizimin e llogaridhënies dhe monitorimit
- Përfshirjen e praktikave të mira dhe modeli i SHMFF
- Validimin e dokumentit përmes ëorkshopit

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore

Ekspteri pritet të:

- Zhvillojë metodologjinë për hartimin e protokollit
- Të bëjë një analizë krahasuese mes modeleve të ngjashme të ofrimit të shërbimeve sociale
- Rishikim të literaturës dhe kontekstit aktual të shërbimeve sociale
- Draftimin e protokollit të punës dhe rishikimin e feedback dhe konsultimeve
- Të udhëheqë validimin e dokumentit në një ëorkshop 1 ditor

Kualifikimet dhe Eksperienca e Kërkuar

Ekspteri duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Arsimi dhe Kualifikimet Akademike:

- Diplomë Master ose më e lartë në Shkenca Sociale (Punë Sociale, Psikologji, Pedagogji ose fusha të ngjashme).

- Kualifikime shtesë në mbrojtjen e fëmijëve, mirëqenien sociale, trajnimin e të rriturve do të jenë avantazh.

Eksperienca Profesionale:

- Të paktën 5 vjet përvojë në hartimin e kurrikulave, manualeve, protokolleve në fushën e shërbimeve sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve
- Eksperiencë pune në mbrojtjen e fëmijëve, parandalimin e abuzimit dhe dhunës në familje, mbështetjen psiko-sociale, deinstitutionalizimin ose fusha të ngjashme.
- Njohje shumë të mirë të kuadrit ligjor në Mbrojtjen dhe përfshirjen sociale

Aftësitë dhe Kompetencat:

- Njohuri mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet sociale dhe deinstitutionalizimit
- Aftësi të shkëlqyera analitike, raportimi dhe përgatitjeje të dokumenteve zyrtare
- Aftësi shumë të mira komunikimi për konsultim me grupe të ndryshme profesionale
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur

Afatet dhe dorëzimet që priten nga eksperti

Eksperti pritet të dorëzojë:

- Draft protokollin e punës – datë 30 qershor 2025
- Koncept notë për zhvillimin e ëorkshop- 5 korrik 2025
- Dokumentin final pas reflektimit të komenteve dhe konsultimeve 25 korrik 2025

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 6 qershor 2025.

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës qershor-korrik 2025.

Kjo ekspertizë përfshin 7 ditë pune.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email :

1. CV-në;
2. Letër interesi që shpjegon dhe përvojën në hartimin e kurrikulave të ngjashme;
3. Letër angazhimi/disponueshmërie;
4. Ofertën financiare.

brenda dates 2 qershor 2025 në info@nisma-arsis.org, në përgjigje të ftesës me email.